



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI

Nr. 1245 Prot.

Pogradec, më 24.03 2022

VENDIM

Nr. 27, DATË 23.03.2022

“PËR

MIRATIMIN E PLANIT TË MBARËSHTIMIT TË EKONOMISË PYJORE BISHNICË (PJESA EKONOMIKE BISHNICË, PJESA EKONOMIKE TALLË) DHE EKONOMIA KULLOSORE GURI I TOP-GJEMTH, NJËSIA ADMINISTRATIVE VELÇAN BASHKIA POGRADEC”.

Të nderuar këshilltarë !

Mbështetur në Ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të Ligjit Nr.57/2020, datë 30.04.2020 “Për Pyjet”, neni 11, pika 2, gërma b, sipas citimit “.. për të gjitha format e pronësisë planet e mbarështimit miratohen nga Ministri. Përjashtimisht për bashkitë, miratimi i planit të mbarështimit shoqërohet me miratimin paraprak të këshillit bashkiak përkatës..”, të Udhëzimit Nr.01, datë 26.01.2017 “Për mbajtjen e Kadastrës së Fondit Pyjor dhe Kullosor Kombëtarë”, të kontratës Nr.192/9, datë 15.04.2021 “Kontratë Shërbimi”, lidhur ndërmjet Bashkisë Pogradec dhe subjektit “Joklen & CO Shpk” sh.p.k, Pogradec-Albania, me Nipt **K84322601F** me adresë: “Rruga Rinia, lagjia nr.2, pallat, kat 1, zona kadastrale nr.8581, numur pasurie 4/4, pogradec”, përfaqësuar nga administratori Maliq Misliu, objekt: “Hartim Plani Mbarështimi i dhe menaxhimi ekonomia pyjore Bishnicë, pjesa ekonomike tallë dhe ekonomia kullosore Guri i top-gjemth” Bashkia Pogradec, dhe Kontratës Nr.629/4 datë 28.07.2020 “Kontratë shërbimi”, lidhur ndërmjet Bashkisë Pogradec dhe subjektit “Joklen & CO Shpk” sh.p.k, Pogradec-Albania, me objekt “Hartim plani Mbarështim dhe Menaxhimi Pyjore Bishnicë (Pjesa Ekonomike Bishnicë)”. Bashkia Pogradec me propozim të Kryetarit të Bashkisë dhe Drejtorit të Ndërmarrjes së Infrastrukturave dhe Punëve Publike pasi u shqyrtua relacioni i përgatitur nga Administrata e Bashkisë ku është argumentuar teknikisht dhe ligjërisht, i kërkohet Këshillit Bashkiak të Bashkisë Pogradec që në mbledhjen e datës 23.03.2022 të miratojë:

VENDOSI:

1. Të miratojë Planin e mbarështimit të ekonomisë pyjore “Bishnicë (pjesa ekonomike



Bishnicë, pjesa ekonomike Tallë), dhe ekonomia Kullosore Guri i Top – Gjemth” të hartuar nga Subjekti Joklen & CO Shpk me NIPT **K84322601F**.

5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë Pogradec, Ndërmarrja e Mirëmbajtjes së Iфраstrukturave dhe Punëve Publike (Sektori i Shërbimit Pyjor), Drejtori e Çështjeve Juridike.
6. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

KRYETAR I KËSHILLIT

Sotirag MANGËRI



